



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:047636  
Datë: 05.11.2024  
Numri i dokumentit: 06406053

C.nr.3585/23

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Mirvet Thaqi dhe me bashkëpunëtoreshen profesionale Argjelina Prenku, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L. B. nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fitim Gashi avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës- Drejtoria për Shëndetësi me seli në Gjakovë, baza juridike: *Kompensim i pagës së 13-të*, vlera e kontestit: 2,260.00 euro, jashtë seancës, me datë 05.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria për Shëndetësi që paditëses L. B. nga Gjakova, që në emër të pagës së 13-të, për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 të ia paguaj në lartësi prej një page bazë në shumën 565.00 euro, për 4 paga, në shumë të përgjithshme prej 2,260.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit nga dita e paraqitje së kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja L. B. nga Gjakova, përmes të autorizuarit të tij, me datë 29.12.2023, ka paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt kontesti: *Kompensim i pagës së 13-të*, vlera e kontestit: 2,260.00 euro, duke përshkruar gjendjen faktike si në vijim: Parashtruesi i kësaj padie është i punësuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjakovë. Kjo dëshmohet edhe me kopjet e

bashkangjitura të kësaj padie. Me datën 12.06.2018 hynë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale, ku në bazë të kësaj marrëveshje parashtruesve të kësaj padie bazuar në nenin 17 par 2 i takon e drejta në katër (4) paga në lartësinë e pagës bazë dhe atë për vitin 2019,2020,2021 dhe 2022. Përkundër obligimit ligjor që në mënyrë zyrtare të bëhet zbatimi i kësaj kontrate lidhur me këtë padi, dhe atë brenda afatit një (1) mujor pas plotësimit të kushteve, deri me tani parashtruesit të padisë nuk janë kompensuar për këto paga të trembëdhjeta ashtu siç parashihet në nenin 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale për Shëndetësi. Meqenëse Kontrata Kolektive Sektoriale nuk po zbatohet zyrtarisht ashtu siç është obligimi ligjor, paditësja i është drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensim të pagave të 13-ta pikërisht në mbështetje të nenit 17 par. 2 të Kontratës Kolektive dhe ndaj të njëjtave organi përgjegjës edhe më tutje nuk ka marrë asnjë veprim qoftë për refuzimin apo përmbushjen e këtyre kërkesave. Konsiderojmë se Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - QKMF në Gjakovë, me kohë do duhej të bënin planifikimin e duhur buxhetor edhe për këtë obligim. Për më tepër paditësi pretendon se e paditura i ka pasur mundësitë financiare për ta përmbushur këtë obligim por të njëjtin ka dështuar ta realizojë më tepër për shkak të neglizhencës në ndërmarrje të veprimeve të duhura në drejtim të realizimit të të drejtave të punëtorëve të saj. Andaj, paditësi tani kërkon nga gjykata që të ushtroj funksionin e saj dhe mos te lejoj shkeljen e të drejtave të paditësit dhe të restauroj kundërligjshmërinë e ndodhur, përkatësisht të vendos në atë mënyrë që në tërësi të respektohet përveç të tjerash parimi i përmbushjes së detyrimeve nga neni 8 i LMD në fuqi dhe pas analizimit të të gjitha fakteve dhe provave të prezantuara i propozojmë gjykatës që pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditësve të e aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përgjigjes në padi ka theksuar se: E konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë lidhur me pagat e 13-ta, ngase me nenin 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale (Shëndetësisë), punëmarrësit ka mundur të i kompensohet paga e 13-të, për çdo vit kalendarik në vlerë të pagës bazë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, mirëpo në këtë rast punëdhënësi nuk ka pasur mundësi buxhetore që paditësve të ju bëjë kompensimin e pagës 13-të, e që rrjedhimisht që kjo kërkesë tashmë është parashkruar. Andaj, nga të lartcekurat i propozojë gjykatës që pas shqyrtimit të lëndës dhe të administrimit të provave të marr aktgjykimi refuzues.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

*-Kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e PABAZUAR.*

Gjykata lidhur me këtë çështje ka vendosur jashtë seancës gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse të çështjes, e në ndërlidhje me nenin 399 par.1 të LPK-së që përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi ishte i punësuar tek e paditura dhe se gëzonin shpërblimin në emër të pagës bazë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, mirëpo kontestuese ishte baza e kërkesëpadiës, pra nëse palës paditëse i takon apo jo e drejta lidhur me kompensim të pagave të 13-ta të papaguara.

Në bazë të kontratës mbi marrëdhënien e punës, me numër protokollit 356 të dt. 22.03.2012, e lidhur në mes të Komuna Gjakovë - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-QKMF-Gjakovë, në cilësi të punëdhënësit dhe L. B. në cilësi të punëmarrësit, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura me kohë të pa caktuar nga data 01.04.2012, ndërsa nga lista e pagave për vitin 2021, lartësia e pagës bazë për paditësen është 565.00 euro, fakt i cili nuk ishte kontestues në mes të ndërgjyqësve.

Gjykata lidhur me bazën e kërkesëpadiës, ka vendosur duke u bazuar në nenin 17.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale e datës 12.06.2018, e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, ku përcaktohet se *“Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 – të për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”*.

Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, çështja e kompensimit të pagës së 13-të, për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka

mjete buxhetore. Nga kjo rezulton se dispozita e sipër theksuar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizimin e pagës së 13-të, lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë nuk arrin të provojë se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Sipas kësaj gjykate, nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit të pagës së 13-të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara, mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës kur gjykata i jep mundësi për t'u deklaruar me prova konkrete, të provoj çështjen e mundësisë buxhetore për shpërblimin e tillë. (*Mendim Juridik i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023*).

Sipas Ligjit nr. 06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, buxheti fillestar për paga dhe mëditje në Komunën e Gjakovës ka qenë 13,488,611 euro. Në nenin 12 par. 4 të këtij ligji është përcaktuar se: *“Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve “Mallra e shërbime” nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të mëditjeve apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat”*. Në anën tjetër, sipas raportit të auditimit për komunën e Gjakovës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018 të publikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit (në tekstin e mëtejme: ZKA), rezulton se buxheti final për paga dhe mëditje ka qenë në shumë prej 13,309,539 euro, ndërsa realizimi për vitin 2018 ka qenë 13,252,491 euro. ZKA-ja ka konstatuar se në krahasim me buxhetin fillestar, buxheti final është zvogëluar për 179,073€, pasi që fillimisht buxheti fillestar ishte rritur për 34,214 euro nga donacionet dhe në fund të vitit me shkurtime buxhetore është zvogëluar për 213,286 euro. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte gati 100%.

Sipas Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, buxheti fillestar për paga dhe mëditje në Komunën e Gjakovës ka qenë 13,701,106 euro. Në nenin 12 par. 4 të këtij ligji është përcaktuar se: *“Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve “Mallra e shërbime” nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të mëditjeve apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat”*. Në anën tjetër, sipas raportit të auditimit për komunën e Gjakovës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2019 të publikuar nga ZKA, rezulton se buxheti final për paga dhe mëditje ka qenë në shumën prej 13,769,244 euro, ndërsa realizimi për vitin 2019 ka qenë 13,599,827 euro, apo shprehur në përqindje është realizuar prej 99%. ZKA-ja ka konstatuar se buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar është rritur për 68,138 euro si rezultat i donacioneve të jashtme dhe formave të tjera të gjenerimit të të hyrave nga kjo komunë.

Sipas Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, buxheti fillestar për paga dhe mëditje në Komunën e Gjakovës ka qenë 13,817,893 euro. Në nenin 12 par. 6 të këtij Ligji është përcaktuar se: *“Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të shtesave apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat, duke përjashtuar rimbursimin apo shpenzimet e lejuara për udhëtimet jashtë vendit, sipas legjislacionit përkatës”*. Përderisa sipas raportit auditimit për komunën e Gjakovës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2020 të publikuar nga ZKA, rezulton se buxheti final për paga dhe mëditje ka qenë në shumën prej 14,263,962.78 euro ndërsa realizimi për vitin 2020 ka qenë 14,242,132.73 euro, apo shprehur në përqindje është realizuar gati 100%. ZKA-ja ka konstatuar se buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 446,070 euro dhe kjo rritje ishte një reflektim i pranimeve nga donacionet, të hyrave vetanake dhe atyre të bartura nga viti i kaluar, pastaj rritja buxhetore nga huamarrja dhe linja vertikale si dhe rimëkëmbja ekonomike. Sipas këtij raporti rezulton se për shkak të situatës pandemike me Covid-19 komuna e Gjakovës kishte shpenzuar buxhet të ndarë për këtë qëllim në vlerë totale prej 1,188,659 euro, prej të cilave 889,674€ ishin për shtesa në paga dhe mallra e shërbime për menaxhimin e emergjencës nga COVID-19.

Nga Ligjet përkatëse të cituara si më lartë, përkatësisht në raport me zërat për ndarje buxhetore, rezulton se Komuna e Gjakovës nuk ka ndarë asnjë linjë buxhetore për paga të 13-ta për vitet 2019 dhe 2020, në anën tjetër realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje është realizuar në atë masë sa nuk rezulton rezervë buxhetore për të mbuluar pagat e 13-ta për punonjësit, përkatësisht në rastin konkret paditësit.

Sa i përket pjesës së kërkesës për pagesën e pagës së 13-të për vitet kalendarike 2021 dhe 2022, gjykata konstaton se bazuar në faktin se Kontratës së lartcekur mbi bazën e së cilës pala paditëse e mbështet themelësinë e kërkesëpadisë i ka skaduar afati i vlefshmërisë me dt.10.06.2021, rezulton se e njëjta ka pushuar të prodhojë efekt juridik. Në këtë kuptim, punëtorët shëndetësorë nuk mund t’i gëzojnë beneficionet e përcaktuara me dispozitat e kësaj Kontrate edhe pas skadimit të afatit të vlefshmërisë së të njëjtës, përfshirë edhe të drejtën e kompensimit të pagës së 13-të për vitet kalendarike 2021 dhe 2022. Si rezultat i një interpretimi të tillë, Gjykata vlerëson se palës paditëse i mungon baza ligjore e mbështetjes së kërkesëpadisë në këtë çështje juridike, respektivisht mbështetja e bazës juridike në një akt juridik të cilit i ka skaduar afati i vlefshmërisë, paraqet fakt i cili është qartazi në kundërtënie me një fakt që Gjykata e konsideron të njohur. Bazuar në një bindje të tillë, nuk është fare e nevojshme të procedohet tutje me

caktimin e seancës gjyqësore për t'u vërtetuar faktet e pretenduara nga pala paditëse, për faktin se ndërmarrja eventuale e këtij veprimi nuk do të ndryshonte pikëpamjet e Gjykatës në raport me themelësinë e kërkesëpadisë.

Nga interpretimi dhe arsyet si më lartë, gjykata ka vendosur që të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar.

Lidhur me prapësimin e të paditurës për parashkrimin e kërkesës:

Gjykata pas vlerësimit të prapësimin material të të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës, ka konstatuar se kërkesa e paditësve është e përfshirë edhe në parashkrim për vitin 2019, duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit Nr.03/L212 të Punës, i cili ka përcaktuar që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e po ashtu pati parasysh edhe nenin 342 par.1 të LMD-së, sipas të cilit *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Paditësit, padinë e kanë paraqitur me datë 29.12.2023, e në qoftë se kërkesa për kompensimin e pagës së 13-të, do të kishte themelësi atëherë e njëjta do të kompensohej në fund të vitit 2019, e që nga fundi i vitit 2019 e deri me paraqitjen e padisë kanë kaluar më shumë se katër (4) vite.

Gjykata ka vlerësuar dhe pretendimet e tjera të palës paditëse e po ashtu edhe asaj të paditur, por të njëjtat nuk kishin ndonjë rëndësi për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës, sepse padisë i ka munguar baza juridike.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata ka vendosur bazuar në nenin 450 *“Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta”*, e lidhur me nenin 463.1 *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”*-të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e bazuar në nenin 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL

C.nr.3585/23, datë: 05.11.2024

Gj y q t a r i:

Mirvet Thaqi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes të kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.